

URDHËR
Nr. 133, datë 8.3.2020

**PËR KUFIZIMIN E LËVIZJES SË SHOQËRUESVE DHE/OSE FAMILJARËVE TË
PACIENTËVE NËPËR SPITALE**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 10107, datë 30.3.2009, “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 7, të ligjit nr. 15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, të vendimit të datës 8.3.2020 të Komitetit të Përkohshëm për Infeksionin e Përhapur nga Coronavirusi i ri, si edhe të udhëzimit të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19,

URDHËROJ:

1. Në ambientet e shërbimeve të urgjencës mjekësore në institucionet e kujdesit shëndetësor ndalohet hyrja e shoqëruesve dhe/ose familjarëve të pacientëve, me përjashtim të rasteve kur një kërkesë e tillë vjen nga drejtoria spitalore.
 2. Në ambientet e shërbimit spitalor, ku janë duke marrë trajtimin spitalor pacientët, ndalohet hyrja e shoqëruesve dhe/ose familjarëve të pacientëve, me përjashtim të rasteve kur një kërkesë e tillë vjen nga drejtoria spitalore.
 3. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri strukturat shëndetësore të urgjencave mjekësore dhe atyre spitalore, si dhe Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu